



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:199415

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05490194

Ac.nr.2760/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Lumni Sallauka dhe Hunaida Pasuli - anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M.K. nga K., e përfaqësuar nga e autorizuara av M. G. nga Klina, kundër të paditurës Komuna e Klinës e përfaqësuar nga Ali Shala, lidhur me zbatimin e vendimit për kompozimin e pagave në bazë të koeficientit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë Dega në Klinë C.nr.20/19, të datës 19.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 19.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e të paditurës Komuna e Klinës, NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë Dega në Klinë C.nr.20/19, i datës 19.03.2021 sa i përket pagesës së diferencës në mes koeficientit 5 dhe 6 dhe tani kjo çështje gjykohet si në vijim: REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses M. K. nga K., me anë të së cilës ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të diferencës së pagesës nga koeficienti 5 në koeficientin 6, për periudhën kohore nga data 02.02.2015 deri me datën 04.07.2018 t’ia paguaj shumën prej 2,402.82 Euro me kamat prej 8% prej datës 02.02.2015 e deri në pagesën definitive.

II. Pika V dhe VI e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë Dega në Klinë C.nr.20/19, i datës 19.03.2021, mbetet e pashqyrtuar.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimit e atakuar C.nr.20/19, të datës 19.03.2021, ka vendosur si në vijim: APROVOHET, padia dhe kërkesëpadia e paditëses M. K. në tërësi, SI E BAZUAR. DETYROHET, e paditura Komuna e Klinës që paditëses M.K. nga K. në emër të diferencës së pagesës nga koeficienti 5 në koeficient 6 , për periudhën kohore prej 02.02.2015 deri me datë 04.07.2018, kur është shfuqizuar aktvendimi nga ana e

Kryetarit të Komunës, të paguaj shumën prej 2.402,82 euro, me kamatë vonesë prej 8% prej dates 02.02.2015, deri ne pagesen defenitive. DETYROHET, e paditura Komuna e Klinës që t'i paguaj edhe shpenzimet procedurale dhe atë: Për padi 104 €, taks gjyqesore 21 €, per 4 seanca të mbajtura nga 4 x 135= 540, ekspertiza finaciare 100 €, për dy parashtrës 208 €, ku totali i shpenzimeve te procedurës është 971 €. Të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me detyrim. REFUZOHET kërkesa e paditëses që për periudhën e ardhëshme të përfshihet në listen e pagave me koeficient te ngritur. REFUZOHET propozimi i të paditurës rreth i kopetencës lëndore te kesaj Gjykate, poashtu edhe kërkesa e të paditurës rreth jashtafatshmërisë dhe palejueshmërisë së padisë.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura përmes përfaqësuesit të saj në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës material, me propozimin sin ë të njejtën.

Paditësja ka parashtruar përgjigje në ankesë, me propozim si në të njejtën.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës, për pagimin e diferencës së kuficientit, për periudhën nga data 02.02.2015 deri me datën 04.07.2018, në shumën prej 2,402.82 Euro.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, në seancën për shqyrtim kryesor ka administruar provat e propozuara nga palët ndërgjyqëse dhe ka vendosur sin ë dispozitivin e Aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në bazë të aktvendimit të datës 02.02.2015 me nr 02-120-1097/2015 ku sipas vendimit të tillë janë kompenzuar disa puntorë, ndersa disa të tjerë nuk janë kompenzuar, ku nder ta është edhe paditësja, ku në këtë rast nuk janë respektuar të drejtat e puntorëve në mënyr të barabart pa ndonjë selektim nga ana e organit përgjegjës, ku në këtë rast me përpikmëri të zbatohen të drejtat e njeriut sipas konventes europiane dhe atë sa i përket nenit 6 të kësaj konvente për një proqes të rregullt. Poashtu sa i përket kompenzimit të paditëses lidhur me periudhën kohore të mos kompenzimit, bindese për gjykatën ishte edhe ekspertiza aktuarisike e datës 17.09.2020, ku ekspertja ka skjaruar në detaj ekspertizën duke e mbrojtur te njetën dhe duke ju përgjigjur pyetjeve te te paditurës, ku pyetjet kan qenë jasht kontestit te ekspertizës, andaj Gjykata ja fali besimin në tërësi një ekspertize te tillë. Gjykata lidhur me çështjen në fjalë u

bazua te Aktvendimi e lëshuar nga ish Kryetari i Komunës Sokol Bashota, ku pala paditëse e bazon një kërkesë të tillë , andaj nga keto arsye Gjykata aprovoi padin dhe kerkesen e saj si të drejt dhe te bazuar. Gjithashtu përfaqësuesi i të paditurës ka kundërshtuar në tërësi caktimin e ekspertizës aktuale dhe me rastin e përpilimit të ekspertizës ,ku pas pranimit të saj , përfaqësuesi i të paditurës ka, kërkuar që ekspertja të ftohet në skjarim dhe nga ky fakt rezulton se përfaqësuesi bie në kundërshtim me deklarinimin rreth ekspertizës. Lidhur me kërkesë e paditëses sa i perket periudhes se ardhëshme prej datës 04.07.2018 që të përfshihet rregullisht në listën e pagave mujore me koeficient të rritur, Gjykata refuzoi një kërkesë të tillë pasi që e njeta nuk është kompetente për ta gjykuar këtë kërkesë, ku pala për këtë çështje mund të i drejtohet Gjykatës kompetente. Poashtu gjykata refuzoi propozimin e palës së paditur rreth kopetecës lëndore të kësaj Gjykate , pasi që e njeta është kompetente për te gjykuar kërkesën e paditëses rreth kompenzimit të pagave për periudhën kohore si nga padia dhe kërkesa e saj. Sa i përket refuzimit të kërkesës së të paditurës rreth jashtafatshmërisë së padisë dhe palejueshmërisë së saj , Gjykata e hudhi poshtë me arsyetim se në bazë të Ligjit nr. 04/L-077 për Mardhënjet e Detyrimeve në nenin 361 te keti ligji ku thuhet se : Kërkesat e vërtetuara nga gjykata ose organet tjera kompetente ,te gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për 10 (dhjetë) vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim të ardhmen,parashkruhen në afatin e paraparë për parashkrimin e kërkesave periodike, çka do të thot se padia është e afatëshme , duke u bazuar në atë se këto vendime janë marrë në mënyr selective nga ana e të paditurës. Andaj Gjykata duke u bazuar ne nenin 143.3 vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit. Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e ka marr ne bazë të dispozites se nenit 449 dhe 452 të LPK-së si dhe ne bazë të tarifës se Odes se avokateve te Kosovës.

Gjykata e Apelit e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës se vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas pretendimeve ankimore të palës ankuese, mirëpo sipas kësaj gjykate gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk korrespondon drejtë me provat nga shkresat lëndore, për pasojë ka pasur edhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Për pasojë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, ka pasur zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, pasi qe gjykata ankimore me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë, konstaton një gjendje tjetër faktike, nga ajo e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike, kjo gjykatë vjen në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është tërësisht e pabazuar, për çka në këtë rast ka kushte që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet konform nenit 201 pika b) dhe d) të LPK-së, ndërsa si rezultat i kësaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit vlerëson se Vendimi i datës 02.02.2015, i nxjerrë nga e paditura, nuk është bazë e mjaftueshme juridike për t'ia njohur të drejtën paditëses për kompensim të diferencës së koeficientit (5 dhe 6), për arsye se i njejti është nxjerrë nga organi jo kompetentë dhe si i tillë nuk prodhon efekt juridik, që nga nxjerrja e tij. Në rastin konkret paditësja kërkesëpadinë e saj e mbështet në një akt administrativ që sipas kësaj gjykate është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, për arsye se është nxjerrë nga organi jo kompetent. Në dispozitën e nenit 92 pika b) të Ligjit Nr. 02/L-28 PËR PROCEDURËN ADMINISTRATIVE, parashihet “*Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme; kur akti është nxjerrë nga organi administrativ jo kompetent*”. Pra nga kjo shihet se kërkesëpadia e paditëses mbështetet pikërisht në këtë vendim, që sipas kësaj gjykate nuk prodhon efekt juridik që nga nxjerrja e tij (efekti juridik i tij është zero) dhe për këtë arsye kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar dhe është refuzuar përmes këtij Aktgjykimi.

Akt administrativ absolutisht i pavlefshëm konsiderohet ai akt që, për shkak të shkeljes thelbësore të ligjit, nuk e ka fuqinë juridike të një akti të vlefshëm, prandaj konsiderohet sikur ai akt të mos ketë ekzistuar fare, për asnjë çast. Pavlefshmëria absolute shpreh një gjendje të mungesës së plotë të veprimit juridik nga akti. Dihet se akti, që në momentin e nxjerrjes së tij, nuk krijon dhe as nuk krijohet pasoja juridike për të cilat është nxjerrë. Një akt i pavlefshëm nuk është fare akt. Në të vërtetë, ai është një “nulitet i plotë, një akt i dështuar, i cili nuk ka hyrë kurrë në fuqi”, prandaj natyrshëm se një akt i tillë “nuk mund të ketë fuqi detyruese ndaj personave a subjekteve, të cilëve u drejtohet” dhe, si rrjedhojë, këta ose çdo organ tjetër, mund të kundërshtojnë drejtpërdrejt plotësimin e detyrimeve a urdhërimeve që rrjedhin prej tij, pa qenë nevoja që për pavlefshmërinë të shprehet domosdoshmërisht ndonjë organ.

Gjykata e Apelit, vlerëson të bazuar pretendimet e të paditurës se në rastin konkret kërkesëpadia e paditëses nuk ka bazë juridike dhe për këtë arsye e njejta përmes këtij aktgjykimi është refuzuar si e pa bazuar.

Për të pasur të drejtë paditësja për kompensimin e diferencës në mes koeficientit 5 dhe 6, duhet që procedura admisnitrative të jetë në përputhje me parimet e procedurës admisnitrative siç janë parimi i ligjshmërisë (neni 3); parimi i balancimit të interesave publike dhe private (neni 4); parimi i barazisë para ligjit neni (5) etj, e që në rastin konkret organi i të paditurës gjatë nxjerrjes së vendimit të datës 02.02.2015 nuk i kam marrë në shqyrtim. Duhet që organi që ka nxjerrë vendimin e datës 02.02.2015 të ketë pasur kompetencë lëndore për një vendim të tillë, që nuk është rasti konkret dhe për këtë arsye kërkesëpadia e paditëses nuk ka bazë juridike.

Pika V dhe VI e dispozitivit të Aktgjykimit të atakuar ka mbetur e pashqyrtuar konform dispozitës së nenin 194 të LPK-së, meqenëse asnjëra palë ndërgjyqëse nuk ka parashtruar ankesë lidhur me këtë pjesë të dispozitivit.

Nga të cekurat me lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, dhe 195 parag.1 pika (d) e LPK-së, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.2760/2021, datë 19.03.2024

Numri i lëndës: 2019:199415
Datë: 22.03.2024
Numri i dokumentit: 05490194

Kryetari i kolegjit,
Ardian Ajvazi